



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 849 / prot.

Pogradec, më 18.02.2026

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Znj. Manjola Kamolli, KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK


E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin dhe relacionet shoqëruese për:

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 130, DATË 22.12.2025 "MBI MIRATIMIN ME BURSË TË NXËNËSVE TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026"

Me respekt

Kryetari

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 faqe

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues: 2 faqe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KRYETARI



Nr. _____ prot.

Pogradec, më _____.2026

PROJEKT-VENDIM

NR. _____, DATË _____.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 130, DATË 22.12.2025
“MBI MIRATIMIN ME BURSË TË NXËNËSVE TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL
PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 28, pika 4, shkronjat “a”, “b” dhe “d”, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të perkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 130 datë 22.12.2025 “Mbi miratimin me bursë të nxënësve të arsimit të mesëm profesional për vitin shkollor 2025-2026” me propozim të kryetarit të bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I:**

1. Miratimin e një ndryshimi në pikën 3. të Vendimit 130, datë 22.12.2025 mbi listën e nxënësve, banues në Pogradec, që përfitojnë bursë për vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional në qytete të tjera për vitin shkollor 2025-2026 duke shtuar në listë nxënësin Artenisio Ferdinand Xhelo.
- 1.1. Nxënësi Artenisio Ferdinand Xhelo, është në klasën e XI në shkollën e mesme profesionale “Charles Telford Erickson” Golem- Kavajë dhe do të trajtohet me bursë të plotë duke përmbushur kriterin 2.1 a) të VKM 666, 10.10.2019.
2. Efektet financiare do të përballohen nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

3. Ngarkohet Qendra Arsimore, Bashkia Pogradec, dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financar, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Akti administrativ eshte i natyrës individuale pasi i drejtohet një subjekti të përcaktuar individualisht të së drejtës dhe si i tillë nuk kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti i qarkut Korçë, sipas ligjit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

K R Y E T A R E

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 610/prot.

Pogradec, më 18.02.2026

RELACION

Në lidhje me Projekt-Vendimin për një ndryshim në Vendimin nr. 130, datë 22.12.2025 "Mbi miratimin me bursë të nxënësve të arsimit të mesëm profesional për vitin shkollor 2025-2026",

I/e nderuar Kryetare e Këshillit!

Të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 28, pika 4, shkronjat "a", "b" dhe "d", të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 130 datë 22.12.2025 "Mbi miratimin me bursë të nxënësve të arsimit të mesëm profesional për vitin shkollor 2025-2026", ju bejmë me dije se:

Duke u mbështetur në shkresën e datës 11.02.2026, me Nr. 61 Prot, me lëndë: Lista emërore e nxënësve të klase XI, dega Veterinari për miratimin me bursë, për periudhën 9 shtator 2025 deri më 13 qershor 2026, për vitin mësimor 2025-2026, nxënësi Artensio Ferdinand Xhelo, me banim në Pogradec por i regjistruar dhe frekuentues në shkollën e mesme profesionale "Charles Telford Erickson", Golem-Kavajë ka dorëzuar dokumentacionin përkatës në bashkinë Kavajë por kjo bashki nuk e ka miratuar përfitimin e bursës pasi bazuar në VKM-të e cituara më sipër është e drejtë respektive vetëm e bashkive ku nxënësit janë banues që të miratojnë vendimin për përfitim burse.

Theksohet se nxënësi Artenisio Ferdinand Xhelo është transferuar pranë shkollës “Charles Telford Erickson” në Janar 2025 dhe për vitin mësimor 2024-2025 ka humbur të drejtën për të përfituar bursë për shkak të vonesave në dorëzimin e dokumentacionit.

Duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, ju ftojmë ta votoni propozimin për miratimin e projekt-vendimit mbi një ndryshim në Vendimin Nr. 130, datë 22.12.2025 “Miratimin me bursë të nxënësve të arsimit të mesëm profesional për vitin shkollor 2025-2026”

Ftojmë Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim.

Të dhënat e Projekt-Vendimit:

Konceptoi: Ledio SHKULLAKU

Miratoi: Anxhela ANDONI

Konfirmoi: Irsa KARAPANÇA

Dritan BABASULI

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI

